



Nr. Prot. 4409
8.2025



Secretary: Përgjithësim,
Vijoni sipas ligjit
Dr. Jem' de' Re
Faqe 1 - 25.08.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHETETËRORE
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT

9457/
Nr. 1 Prot.

Tiranë, më 22.8.2025

Lënda: Kërkohej prononcim për përfshirje të pasurisë në procedurë privatizimi.

BASHKISË KOLONJË ✓

Ersekë

Për dajeni: Znj. ALDA ELMAZAJ

Rr. "Fatmir Haxhiu" Apt.2, Shk.3, Kt.I, "Union Dental Clinic"

Tiranë

Pranë institucionit tonë Znj. Alda Elmazaj nëpërmjet kërkesës protokolluar në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me nr.9457, datë 17.07.2025, rishpreh interesin për privatizimin e objektit "Zyra të ish Fermës lokale Fruti-Kulturë" me vendndodhje në Leskovik, Ersekë.

Theksojmë se me anë të shkresës nr.4998/1prot., datë 24.12.2024 protokolluar pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me nr.12666/3, datë 30.12.2024 keni dërguar "Prononcimin për përfshirjen të pasurisë në procedurë privatizimi" sëbashku me Vendimin e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Kolonjë nr.124, datë 26.11.2024 "Për dhënie dakordësie për fillimin e procedurave për privatizimin e pasurisë nr.6/40, z.k. 2430 Leskovik, me sip. truall 367.46 m², ku nga kjo 112.47 m² është ndërtesë të objektit me emërtimin Zyra të ish-Fermës lokale Fruti-Kulturë" dhe përfaqësuesin e Bashkisë Kolonjë në komisionin e vlerësimit të objektit. Me anë të shkresës nr.4998/2prot., datë 13.02.2025 protokolluar pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me nr.2768, datë 17.02.2025 keni dërguar përgjigjen e Prefektit të Qarkut Korçë rreth verifikimit të bazueshmërisë ligjore për Vendimin nr.124, datë 26.11.2024 të Këshillit Bashkiak, ku nuk është mbajtur një qëndrim nga Prefekti i Qarkut Korçë me arsyetimin se në bazë të Ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin" neni 16, pika 2, gërma "a" vendimi është dërguar me vonesë në tejkalim të afatit 10 ditor.

Për sa më sipër, kërkojmë të kryeni procedurën për miratimin e privatizimit për objektin "Zyra të ish Fermës lokale Fruti-Kulturë" me vendndodhje në Leskovik, Ersekë sipas dispozitave dhe afateve të përcaktuara ligjore.

Po ju rikujtojmë se, në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe të VKM-së nr.926, datë 29.12.2014 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes” të ndryshuar dhe udhëzimit në zbatim të tij, për të përfshirë në procesin e privatizimit pronat që kanë kaluar në pronësi/administrim të pushtetit vendor, nevojitet miratimi i këshillit të bashkisë i konfirmuar në prefekturën përkatëse, në origjinal ose në kopje të njehsuar me origjinalin.

Gjithashtu, nëse organet përkatëse të qeverisjes vendore shprehen dakord për privatizimin e pasurisë së sipërcituar, në zbatim të VKM-së nr.926, datë 29.12.2014 të ndryshuar, krahas dokumentacionit të mësipërm duhet të dërgoni emrin e përfaqësuesit të institucionit, që do të marrë pjesë në komisionin e vlerësimit, si dhe procedurat që lidhen me privatizimin, përfshirë edhe caktimi i përfaqësuesit të institucionit në komisionin e vlerësimit, janë kompetencë e titullarit të institucionit administrues.

Bashkëlidhur gjeni kërkesën e subjektit të interesuar si dhe dokumentacionin shoqërues.

Duke ju falenderuar,

MINISTËR
Blendi GONXHJA



Tiranë me datë 17.07.2025

K E R K E S E

MINISTRISË SË KULTURËS, EKONOMISË DHE INOVACIONIT

DREJTORISË SË PRIVATIZIMIT

Duke ju falenderuar paraprakisht që po ju marrim kohën tuaj nëpërmjetë kësaj kërkesë, shpresojmë në angzhimit tuaj maksimal për vlerësimin e kërkesë tonë.

Nëpërmjet shkresës tonë të datës 14.10.2024, numërtuar me tuajen nr. 12666 në të njëjtën datë, në zbatim të legjislacionit për privatizimin e pronës shtetërore, kam shprehur interesin për përfshirjen në procedurën e privatizimit të objektit “zyrat e ish-fermës lokale fruti-kulturë”, me vëndndodhje në qytezën Leskovik, Bashkia Kolonjë.

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe VKM-së 926 datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurat e shtjes”, si dhe udhëzimin në zbatim të tijë, me shkresën nr. 12666/1 datë 24.10.2024, keni kërkuar prononcimin e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Kolonjë, për miratimin e privatizimit të objektit të kërkuar nga ana ime.

Nga Bashkia Kolonjë, me shkresën 4998/1 datë 24.12.2024, jam njoftuar se, me vendimin nr.124 datë 26.11.2024, të Këshillit Bashkiak Kolonjë, është miratuar kërkesa e Ministrisë së Kulturës, Ekonomisë dhe Inovacionit, për vazhdimin e procedurave të privatizimit të pasurisë nr. 6/40 zk 2430 Leskovik, me sipërfaqe trualli 367.46 m², nga ku 112.47 m² ndertesë, të objektit me emrin “zyrat e ish-fermës lokale fruti-kulturë”.

Gjithashtu, Bashkia Kolonjë, me shkresën 4998/2 datë 13.02.2025, ma ka adresuar shkresën nr.60/1 datë 21.01.2025, të Prefektit të Qrkut Korçë, ku rezulton se nga ana e Prefektit z. Nertil Jolë, nuk ka një qëndrim mbi vendimin nr. 124 datë 26.11.2024, të Këshillit Bashkiak Kolonjë, me pretendimin se është paraqitur (tej afatit 10 ditorë) me vonesë.

Bazuar sa më sipër, në kushtet që unë vazhdoj të jem e interesuar për privatizimin e objektit të sipërcituar, ndërkohë dhe institucioni administrues i pronës, nëpërmjetë korrespondencave shkresore të tijë, ka shprehur dakortësinë për vijimin e procedurave privatizuese të kësaj prone, lutemi nga ana juaj, të ridërgoni një kërkesë të re në adresë të Bashkisë Kolonjë, për një vendimmarrje rishtas nga Këshilli Bashkiak, i cili ti dërgohet Prefektit për miratim brenda afatit ligjorë.

Mbetem me shpresë se kërkesa ime do të merret në konsideratë në një hapsirë kohore sa më të shpejtë.

Me respekt
Alda Elmazaj

Adresa: Rr. “Fatmir Haxhiu”, Apt. nr.2 SHk. 3, Kt. I dhe/ose klinika “Union Dental Clinic”, Tiranë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 4998/1 Prot.,

Ersekë, më 24. 12. 2024

Lënda: KTHIM PËRGJIGJIE

DREJTORIA E PRIVATIZIMIT

Për dijeni: Znj. ALDA ELMAZAJ
Rr. "Fatmir Haxhiu" Ap. 2, Shk. 3, Kt.1, "Union Dental Clinic"

Në përgjigje të kërkesës suaj nr. 12666/1 Prot. Datë 24.10.2024 protokolluar me tonën me nr. 4998 Prot.datë 25.10.2024 "*Prononcim për përfshirje të pasurisë në procedure privatizimi*", ju vëmë ne dijeni se: Është marrë vendimi për vazhdimin e procedurave për privatizimin e pasurisë nr. 6/40, Z.K 2430 Leskovik, me sipërfaqe trualli 367.46 m² ndërtesë, të objektit me emrin "Zyra të ish-fermës lokale fruit-kulturë".

Më poshtë ju vëmë në dispozicion të dhënat për përfaqësuesin e institucionit që do të marrë pjesë në komisionin e vlerësimit sipas tabelës së më poshtme:

Institucioni	Emër	Mbiemër	Adresë emaili zyrtare
Bashkia Kolonjë	Petro	Risto	petro.risto@kolonja.gov.al Nr. kontakti: +355692799839

Bashkangjitur po ju dërgojmë, vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 124, datë 26.11.2024 "Për dhënie dakordësie për fillimin e procedurave për privatizimin e pasurisë Nr.6/40, Z.K.2430 Leskovik, me sip.trualli 367.46 m²".

Faleminderit për bashkëpunimin!

Konceptoi: K.Brame
Specialiste DPZHT-së

Kontrolloi: L.Bendo
Specialiste DPZHT-së

Konfirmoi: Ing. M. Tartari
Drejtori DPZHT-së

KRYETARI I BASHKISË
Erion Isai



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.124 Datë 26.11.2024

“PËR DHËNIE DAKORDËSIE PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PRIVATIZIMIN E PASURISË NR. 6/40 , Z.K. 2430 LESKOVIK, ME SIP. TRUALLI 367.46 M2, KU NGA KJO 112.47 M2 ËSHTË NDRTESË, TË OBJEKIT ME EMËRTIMIN “ZYRA TË ISH-FERMËS LOKALE FRUTI-KULTURË ”.

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Vendim Të Këshillit Të Ministrave Nr. 819, datë 29.11.2007 “Për privatizimin e pasurive të ndërmarrjeve apo të institucioneve shtetërore” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926 datë 29.12.2014 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo kalohet dhe procedurë e shitjes” -bazuar në kërkesën Nr. 4998 Prot., datë 25.10.2024, me propozim të Kryetarit të bashkisë, Këshilli i Bashkisë Kolonjë, në mbledhjen e datës 26.11.2024,

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për vazhdimin e procedurave për privatizimin e pasurisë nr. 6/40, Z.K 2430 Leskovik, me Sipërfaqe trualli 367.46 m2, nga ku 112.47 m2 ndërtesë, të objektit me emërtimin “Zyra të ish-fermës lokale fruti-kulturë”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen administrata e Bashkisë Kolonjë dhe Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Vota Pro 9

Vota Kunder 0

Abstenim 0

Zbardhur me datë 26.11.2024

KRYETARI I KËSHILLIT
ERALDO XHELILI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 4998/prot.
12

Ersekë më 13.02.2025

Lënda: **KTHIM PËRGJIGJIE**

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËS SHTETËRORE
DREJTORISË SË PRIVATIZIMIT**

Adresa: Rr. "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Tiranë; www.meki.gov.al; info@meki.gov.al

Për dijeni: Znj. ALDA ELMAZAJ

Adresa: Rr. "Fatmir Haxhiu", Apt.2, Sh.3, Kt.1, "Union Dental Clinic", Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr.12666/1 Prot., datë 24.10.2024 protokolluar me tonën me nr. 4998 Prot., datë 25.10.2024, "Kërkesë për prononcim për përfshirje të pasurisë në procedurë privatizimi" po ju sqarojmë si më poshtë vijon:

-Po ju dërgojmë bashkëngjitur shkresën e Këshillit të Bashkisë drejtuar Prefektit të Qarkut Korçë "Dërgojmë Vendimet e Këshillit të Bashkisë Kolonjë" me nr. 192 Prot datë 13.01.2025 dhe kthim përgjigje të Prefektit të Qarkut me nr. 60/1 datë 21.01.2025 protokolluar me tonën me nr. 192/1 Prot, datë 27.01.2025 "Kthim përgjigje" përsa i përket objektit "Zyra të ish-fermës lokale Fruti-Kulturë" me vendndodhje në Leskovik.

Duke ju falenderuar !

Ing. Muharem Tartari

Drejtori DPZHT-së

**Muharem
Tartari**

Digitally signed by Muharem Tartari
Date: 2025.02.12 16:23:29 +02'00'

KRYETARI I BASHKISË

Erion Isai

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
NËNKRYETAR
Petro Risto**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 92 Prot

Ersekë, më 13/01/2025

Lenda : Dërgojmë Vendimet e Këshillit të Bashkisë Kolonjë

PREFEKTIT TË QARKUT
KORÇË

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në lidhje me Vendimin Nr. 124, datë 29.11.2024 “Për dhënie dakordësie për fillimin e procedurave për privatizimin e pasurisë nr. 6/40 , z.k. 2430 Ileskovik, me sip. truall 367.46 m2, ku nga kjo 112.47 m2 është ndërtesë, të objektit me emërtimin “zyra të ish-fermës lokale fruti-kulturë” dhe me kërkesë të të interesuarit kërkojmë nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë shprehje për Vendimin e sipërcituar sipas ligjit.

Duke ju falenderuar!

KRYETARI I KËSHILLIT
ERALDO XHELILI



1841
27.01.2025

Nr. 60 Prot.

Lënda: Kthim përgjigje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
PREFEKTI I QARKUT KORÇË

Shënim i Përgjigjes
Vijeni sipas ligjit
Këshillit Bashkiar
27.01.2025

Korçë, më 21.01.2025

KËSHILLIT TË BASHKISË KOLONJË
KRYETARIT TË KËSHILLIT
Z. ERALDO XHELILI

ERSEKË

Pasi u vumë në dijeni të shkresës tuaj nr. 192 prot., datë 13.01.2025, me titull "Dërgojmë vendimin e Këshillit të Bashkisë Kolonjë", konstatojmë se ky këshill, në mbledhjen e datës 29.11.2024, ndër të tjera, ka miratuar vendimin nr. 124, datë 26.11.2024, me objekt "Dhënie dakordësie për fillimin e procedurave për privatizimin e një pasurie me nr. 6/40, ZK. 2430, Leskovik, objekt me emërtimin 'zyra të ish-fermës lokale fruti-kulturë'".

Nga verifikimi në zyrën e arkivë-protokollit të institucionit, rezulton se është administruar shkresa nr. 5654 prot., datë 03.12.2024, drejtuar institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë, me titull "Dërgojmë vendimet e Këshillit të Bashkisë Kolonjë të datës 26.11.2024", me qëllim verifikimin e bazueshmërisë ligjore të akteve të Këshillit të Bashkisë Kolonjë. Nga leximi i kësaj shkresë, vërejmë se vendimi nr. 124, datë 26.11.2024, i Këshillit të Bashkisë Kolonjë, nuk është dërguar për verifikimin e bazueshmërisë ligjore në institucionin tonë. Në shënimin e bërë në shkresë, institucionit tonë i vihet në dijeni se, në mbledhjen e datës 26.11.2024 të Këshillit të Bashkisë Kolonjë, u miratuan edhe 4 (katër) vendime të tjera me karakter kolektiv ose individual, përfshirë dhe vendimin nr. 124, datë 26.11.2024, me objekt "Dhënie dakordësie për fillimin e procedurave për privatizimin e një pasurie me nr. 6/40, ZK. 2430, Leskovik, objekt me emërtimin 'zyra të ish-fermës lokale fruti-kulturë'".

Bazuar në nenin 16, pika 2 e ligjit nr. 107/2016 "Për Prefektin", institucionit të Prefektit të Qarkut i takon të verifikojë ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, pa penguar zbatimin e tyre. Në gërmën "a" të kësaj pike parashikohet që "çdo organ i njësisë së vetëqeverisjes vendore është i detyruar të depozitojë te Prefekti i Qarkut të gjitha aktet me karakter normativ, brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së tyre. Aktet me karakter normativ shoqërohen me një relacion përmbledhës të arsyeve për nxjerrjen e tyre, duke argumentuar për problematikën, qëllimet, objektivat që synohen të arrihen, përparësitë, si dhe efektet e pritshme nga miratimi. Marrja dijeni nga prefekti i qarkut për aktin e depozituar nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore vërtetohet me regjistrimin e tij në zyrën e protokollit të Prefektit".

Ndërsa pika 1 e nenit 4 të ligjit nr. 107/2016, i ndryshuar, parashikon se "Akte me karakter normativ" janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore. Përmes të cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.

Referuar dispozitave të mësipërme, vlerësojmë se kjo është edhe arsyeja për të cilën vendimi nr. 124, datë 26.11.2024, i Këshillit të Bashkisë Kolonjë, nuk është depozituar për verifikimin e bazueshmërisë ligjore.

Megjithatë, Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 5222, datë 26.06.2015, për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", i ndryshuar, parashikon që "Në zbatim të pikës 2, kreu I, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, institucionet qendrore dhe organet e qeverisjes vendore dërgojnë prononcimin e tyre për privatizimin e pasurive të ndërmarrjeve apo të institucioneve, në administrim apo në pronësi të tyre, në ministrinë përgjegjëse për ekonominë. Për të përfshirë në procesin e privatizimit pronat që i kanë kaluar në pronësi pushtetit vendor, është i nevojshëm miratimi përkatës i këshillit bashkiak dhe konfirmimi nga institucioni i prefektit për ligjshmërinë e tij."

Në lidhje me mbështetjen ligjore të cituar nga ju për miratimin e këtij akti, projekt-vendimit dhe relacionit bashkëlidhur, dërguar me shkresën tuaj nr. 192 prot., datë 13.01.2025, vërejmë se miratimi dhe nxjerrja e këtij akti është bërë nga organi kompetent i njohur nga ligji, në këtë rast Këshilli i Bashkisë Kolonjë, duke iu referuar nenit 9, pika 1.2, nenit 54, gërma "e" dhe nenit 55, pika 3, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, i cili përcakton numrin e votave të nevojshme të anëtarëve të Këshillit që duhen për miratimin e aktit.

Po ashtu, organi ekzekutiv që ka paraqitur projekt-aktin për miratim në këshill dhe Këshilli i Bashkisë Kolonjë është bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet, dhe procedurën e shitjes", i ndryshuar, i cili ka për objekt miratimin e kriterëve të vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes. Sipas pikës 2, kreu I të këtij vendimi, përcaktohet se "Institucionet qendrore dhe organet e njësive të vetëqeverisjes vendore dërgojnë kërkesat e tyre për privatizimin e ndërmarrjeve apo të institucioneve që kanë në varësi administrative ose në pronësi, në ministrinë përgjegjëse për ekonominë. Ministri përgjegjës për ekonominë nxjerr urdhrin e miratimit për privatizim, sipas kërkesave të përmendura më sipër. Në rast se ministria përgjegjëse për ekonominë u kërkon institucioneve qendrore apo organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore kërkesën për prononcim privatizimi për pasuritë e ndërmarrjeve apo të institucioneve që kanë në varësi administrative, këto institucione janë të detyruara që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, të dërgojnë mendimin e tyre për privatizimin e këtyre pasurive".

Në përfundim, sugjerojmë që për akte të tjerë të ngjashëm, të cilët mund të jenë objekt i miratimit në këshillin bashkiak, Këshilli i Bashkisë Kolonjë të referohet edhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 5222, datë 26.06.2015, për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", i ndryshuar".

Duke ju falenderuar,

